



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.24 dhe nenit 38 të Ligjit Nr. 06/L – 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykata, nenit 15 të Rregullore Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarin e Brendshme të Gjykatave të Republikës të Kosovës, Rregullore Nr.03/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 18 maj 2023,

Miraton:

RREGULLORE Nr. 06/2023

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORE NR. 04/2022 PËR PROCEDURËN E REKRUTIMIT, PËRZGJEDHJES DHE THEMELIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR ADMINISTRATORË TË GJYKATAVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullore Nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave.

Neni 2

Neni 2 i rregullores bazë, paragrafi 1, pika 1.5. riformulohet me tekstin si në vijim:

- 1.5. **Njësia** – Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe ka të njëjtin kuptim në tërë tekstin e rregullores aty ku është përdorur;

Neni 3

Neni 9 i rregullores bazë, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Këshilli fillimisht shpall konkurs të brendshëm në kuadër të sistemit gjyqësor, për pozitën e lirë të administratorit, jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë para përfundimit të marrëdhënies së punës. Në rast se nuk plotësohet pozita, Këshilli shpall konkurs të jashtëm të rekrutimit për pozitën e administratorit.

1.1. Konkursi publikohet së paku në një (1) nga mjetet e informimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit;

1.2. Për kandidatët e komunitetit jo-shumicë, konkursi publikohet në mjete të informimit publik të komuniteteve jo-shumicë, në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në Republikën e Kosovës.

2. Neni 9 i rregullores bazë, paragrafi 2, fshihet nga teksti i rregullores.

Neni 4

Neni 18 i rregullores bazë, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 18

Vlerësimi i integritetit të kandidatit

Vlerësimi i integritetit të kandidatit për administrator, bëhet përmes vërtetimit dhe verifikimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale dhe sigurimi i të dhënave për masat eventuale disiplinore të shqiptuara nga punëdhënësi, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 5

1. Neni 20 i rregullores bazë, paragrafi 5, riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Kandidati më i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin e përgjithshëm (me shkrim dhe me gojë) ka arritur më së shumti pikë, por jo më pak se gjashtëdhjetë (60 %) përqind të totalit të pikëve. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e arrin këtë prag, atëherë Komisioni për Rekrutim njofton me raport me shkrim kryesuesin. Këshilli vendos sipas dispozitave të kësaj rregullore për përsëritjen e konkursit.

2. Neni 20 i rregullores bazë, paragrafi 6, riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Komisioni për Rekrutim përpilon listën e kandidatëve sipas pikëve të fituara në provim. Renditja e kandidatëve bëhet sipas rezultatit më të lartë të fituar në testin me shkrim dhe

intervistën me gojë dhe përmes Njesisë publikohet në faqen zyrtare të Këshillit në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e përfundimit të procedurës së rekrutimit.

Neni 6

1. Neni 21 i rregullores bazë, në paragrafin 1, togfjalëshi “afati tre (3) ditë” zëvendësohet në togfjalëshi “ në afat prej tetë (8) ditë”.

2. Neni 21 i rregullores bazë, paragrafi 6, riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Kandidati i pakënaqur me vendimin e Komisionit për Rishqyrtim sipas këtij neni, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afat prej tridhjetë (30) ditëve.

Neni 7

Neni 22 i rregullores bazë, paragrafi 2, i rregullores riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Raporti sipas paragrafit 1 i këtij neni i dorëzohet kryesuesit, i cili pas miratimit publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 8

Neni 23 i rregullores bazë, fshihet nga teksti i rregullores.

Neni 9

Neni 27 i rregullores bazë, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 27

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës

1. Kandidati i suksesshëm pas përzgjedhjes nga Këshilli, themelon marrëdhënien e punës me Këshillin, pas nënshkrimit të akt emërimit.

2. Akti i emërimit me të cilin emërohen administratorët e gjykatave është i karrierës dhe themelohet pa afat.

Neni 10

Neni 28 i rregullores bazë, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 28
Përmbajtja e aktit të emërimit

1. Akti i emërimit, përgatitet në gjuhën që është në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe përmban të dhënat si në vijim:

- 1.1. numrin referues të shpalljes së rekrutimit;
- 1.2. numrin referues të raportit për përzgjedhjen e suksesshme;
- 1.3. emrin dhe adresën zyrtare të institucionit punëdhënës;
- 1.4. emrin dhe adresën e kandidatit të emëruar;
- 1.5. titullin e vendit të punës;
- 1.6. kategorinë funksionale dhe gradën e vendit të punës;
- 1.7. kodin buxhetor të pozitës përkatëse;
- 1.8. llojin e emërimit dhe kohëzgjatjen;
- 1.9. kohëzgjatjen e periudhës provuese;
- 1.10. datën e hyrjes në fuqi të aktit të emërimit.

2. Akti i emërimit, gjithashtu përmban:

- 2.1. një dispozitë, e cila përcakton se i emëruari i nënshtrohet Ligjit për Shërbimin Civil dhe akteve të miratuara në Këshill;
- 2.2. një deklaratë e të emëruarit, me të cilën ai pranon dhe pajtohet me kushtet e punësimit në pozitën përkatëse në shërbimin civil të Kosovës;
- 2.3. nënshkrimin e të emëruarit për pranimin e pozitës dhe datën.

3. Të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me akt emërim dhe këtë rregullore, rregullohen në bazë të parimeve të përgjithshme të ligjeve në fuqi për aq sa nuk e cenojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare të sistemit gjyqësor.

Neni 11

Neni 29 i rregullores bazë, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 29
Puna provuese

1. Puna provuese përcaktohet me akt emërim.

2. Kandidati i suksesshëm i cili emërohet nga Këshilli në pozitën e administratorit i nënshtrohen punës provuese në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve.

3. Puna provuese në rast të pushimit të lehonisë, pushimit mjekësor, shërbimit ushtarak apo rrethana të tjera të veçanta, zgjatet për aq kohë sa është bërë ndërprerja e punës provuese.

4. Kryetari i gjykatës bën vlerësimin e periudhës provuese të administratorit gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të punës provuese dhe për këtë me raport vlerësimi e njofton Njësinë.

5. Administratori sipas legjislacionit në fuqi, ka të drejtë ankese ndaj vendimit për moskonfirmim për vazhdim të marrëdhënies së punës në fund të punës provuese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit nga Njësia.

Neni 12

Neni 30 i rregullores bazë, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 30 Kompensimi i Komisioneve

Anëtarët e Komisioneve të themeluara me këtë rregullore, për punën e tyre në komision, kompensohen në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Neni 32 i rregullores bazë, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 32 Dispozitat kalimtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore në afat prej tridhjetë (30) ditëve në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kontratat e punës të administratorëve aktual zëvendësohen në akt emërim të llojit të emërimit të karrierës.

2. Këshilli me akt tjetër nënligjore rregullon vlerësimin e performancës, procedurën e disiplinimit si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës të administratorit.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

 Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 19.05.2023